

K E R K E S E

PER KONSTATIMIN E HEQJES SE LIRISE ME BURGIM NE RRUGE JASHTEGJYQESORE DHE MARRJEN E VENDIMIT BRENDIA 48 OREVE PER LIGJSHMERINE E KESAJ MASE TE MARRE NGA I.E.V.P. PEQIN NDAJ SHTETASIT DRITAN DAJTI.

Kerkues:

Dritan Dajti, i biri i Hasanit dhe i Aferditës, i datelindjes 17.11.1971, lindur dhe banues ne Tirane, me arsim të lartë, me gjëndje civile i martuar, me shtetësi e kombësi shqiptare, aktualisht duke vuajtur denimin me burgim prane I.E.V.P. Peqin, perfaqesuar nga av.**Alban Kapxhiu** dhe av.**Alban Qafa**.

Objekti:

1. Konstatimi i heqjes se lirise me burgim ne rruge jashtegjyqesore dhe marrja e vendimit brenda 48 oreve per ligshmerine e kesaj mase te marre nga I.E.V.P. Peqin ndaj shtetasit **Dritan Dajti**.
2. Deklarimin kryesisht te shuarjes se denimit me 25 vjet burgim, te shtetasit Dritan Dajti.
3. Lirimin e menjehershëm te shtetasit Dritan Dajti.

Baza Ligjore:

Neni 28 Pika 4, i Kushtetutes dhe Neni 480 i K.Pr.Penale.

P E R P A R A

GJYKATES SE SHKALLES SE PARE TE JURIDIKSIONIT TE PERGJITHSHEM

E L B A S A N

E nderura Gjykate!

Dinamika e Vuajtjes se Denimit e perlllogaritur nga autoritetet e I.E.V.P.Peqin ne date **11.06.2024**, e cila eshte paraqitur si prove perpara Gjykates se Shkalles se Pare Elbasan ne nga I.E.V.P. Peqin, ne daten **30.07.2024**, tregon qarte se:

Kerkuesi Dritan Dajti, ndonse prej dates 17.08.2024, ka perfunduar ekzekutimin e vendimit të dënimit te tij me 25 vjet burgim sipas Vendimit Nr.1108, date 11.05.2020, te Gjykates se Rrethit Gjyqësor Elbasan; ndodhet prej dy ditesh ne kushtet e heqjes se lirise me burgim ne rruge jashtegjyqesore, nga autoritetet e I.E.V.P.Peqin.

Kapitulli I. Fakte e rrethana.

Me 29 Qershor 2004, me Vendim Nr.711, Gjykata e Shkalles se Pare Tirane ka vendosur denimin perfundimtar te te burgosurit **Dritan Dajti** me **20 vjet burgim**, per veprat penale “Vrasja me paramendim” e shtetasit Agim Beqja, parashikuar nga Neni 78/1 i K.Penal; “Vjedhja me dhune” kryer ne bashkepunim, parashikuar nga nenet 139 e 25 te K.Penal; dhe “Mbajtja pa leje e armeve luftarake”, parashikuar nga Neni 278/2 i K.Penal.

Me 14 Nentor 2005, me Vendim Nr.1101, Gjykata e Shkalles se Pare Tirane ka vendosur denimin perfundimtar te te burgosurit **Dritan Dajti** me **9 vjet burgim**, per veprat penale “Largimi i te burgosurit nga vendi i qendrimit” kryer me perdorimin e armes, parashikuar nga Neni 323/2 i K.Penal; “Kanosja per shkak te detyres”, parashikuar nga Neni 238 i K.Penal; “Mbajtja pa leje e armeve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i K.Penal.

Me 17 Mars 2006, me Vendim Nr.146 Akti, Gjykata e Shkalles se Pare Tirane ka vendosur bashkimin e denimeve te Vendimit Nr.711 date 29.06.2004 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, me Vendimin Nr.1101 date 14.11.2004, duke e denuar perfundimisht kerkuesin **Dritan Dajti** me **23 vjet burgim**.

Me 23 Korrik 2014, me Vendim Nr.95, Gjykata e Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane ka shpallur fajtor dhe ka denuar te pandehurin **Dritan Dajti** me “**burgim te perjetshem**”, per kryerjen kater here te vepres penale “Vrasje ne rrethana te tjera

cilesuese", ndaj punonjesve te policise Fatos Xhani, Sajmir Duçkollari, Altin Dizdari dhe Kastriot Feskaj, parashikuar nga Neni 79, Pika "c" i Kodit Penal.

Me 01 Dhjetor 2014, me Vendim **Nr.122**, Gjykata e Apelit per Krime te Renda Tirane, ka vendosur *"Prishjen e vendimit Nr.95, date 23.07.2014, te Gjykates per Krime te Renda, Tirane dhe kthimin e akteve per rigjykim, ne po ate gjykate, me tjetër trup gjykues"*.

Me 13 Korrik 2016, me Vendim **Nr.153 (1220)**, Kolegji Penal i Gjykates se Larte ka vendosur *"Prishjen e vendimit Nr.122, date 01.12.2014 te Gjykates se Apelit per Krime te Renda dhe kthimin e çeshtjes per rishqyrtim ne po ate gjykate me tjetër trup gjykues"*.

Me 08 Shkurt 2019, me Vendim **Nr.13**, Gjykata e Apelit per Krime te Renda, ka vendosur:

1. *Lenien ne fuqi te vendimit Nr.95, date 23.07.2014 te Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane.*
2. *Ne aplikim te nenit 406/1 te K.Pr. Penale, i ndryshuar me ligjin 8813, date 13.06.2002, ne fuqi ne kohen e kryerjes se veprave penale, denimin perfundimisht te pandehurin **Dritan Hasan Dajti** me 25 vite burgim.*

Me 13.03.2019, Prokuroria prane Gjykates se Apelit per Krime te Renda ka ushtruar rekurs kunder Vendimit Nr.13, date 08.02.2019, te Gjykates se Apelit per Krime te Renda, duke kerkuar *Prishjen e Vendimit Nr.13, date 08.02.2019, te Gjykates se Apelit per Krime te Renda Tirane dhe lenien ne fuqi te Vendimit Nr.95, date 23.07.2014 te Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane.*

Me 05 Prill 2019, me Urdherin **Nr.2960/2**, Drejtori i Pergjithshem i Burgjeve ka bere transferimin e te denuarit Dritan Dajti nga I.E.V.P. "Mine Peza", ne I.E.V.P. Peqin me shenimin: *Ti behet kerkese Prokurorise perkatese per bashkim denimesh.*

Me 09 Maj 2019, me Shkresen **Nr.2028** Prot., Drejtori i I.E.V.P Peqin, bazuar ne Urdherin e mesiperm te Drejtorit te Pergjithshem te Burgjeve, i ka kerkuar Prokurorise se Krimeve te Renda fillimin e procedures per bashkimin e denimit me 23 vjet burgim sipas Vendimit **Nr.146** Akti date 17.03.2006, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane; me denimin 25 vjet

burgim sipas Vendimit **Nr.13**, date 08.02.2019, te Gjykates se Apelit per Krime te Renda Tirane.

Me 12 Korrik 2019, me Shkresen **Nr.5980** Prot., Prokuroria Prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane, i eshte pergjigjur kerkeses se mesiperme te I.E.V.P. Peqin se pas ndryshimeve te bera ne K.Pr.Penale me Ligjin 35/2017 date 30.03.2017, kompetente per shqyrtimin e kerkeses per bashkimin e denimeve ishte Gjykata e Shkalles se Pare te Juridiksionit te Pergjithshem Elbasan.

Me 11 Maj 2020, me **Vendimin Nr.1108**, Gjykata e Shkalles se Pare Elbasan, **ka bere bashkimin ne nje denim te vetem** te denimit 23 vjet burgim te Vendimit **Nr.146** Akti date 17.03.2006, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane; me denimin 25 vjet burgim te Vendimit **Nr.13**, date 08.02.2019, te Gjykates se Apelit per Krime te Renda (lidhja 1).

Me 26.05.2020, Vendimi i mesiperm i bashkimit te denimeve me **Nr.1108**, i Gjykates se Shkalles se Pare Elbasan, duke qene se nuk eshte ankimuar nga palet, ka marre forme te prere dhe eshte vene ne ekzekutim nga Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare Elbasan ne daten **29.06.2020**.

Me 13 Korrik 2022, me Vendimin **Nr.579**, Gjykata e Shkalles se Pare Elbasan ka vendosur perfitimin 1 vit amnisti (shuarje) nga vuajtja e denimit te dhene me Vendimin **Nr.146**, date 17.03.2006 te Gjykates se Shkalles se pare Tirane ndaj te denuarit **Dritan Dajti**.

Me 26 Qershor 2023, me Vendim **Nr.1091**, Gjykata e Apelit Tirane, pasi ka shqyrtuar ankimin e Prokurorit prane Gjykates se Shkalles se Pare Elbasan kunder vendimit te mesiperm, ka vendosur lenien ne fuqi te Vendimit **Nr.579** date 13.07.2022 te Gjykates se Shkalles se Pare Elbasan.

Me 30 Prill 2024, Gjykata e Shkalles se Pare e Juridiksionit te Pergjithshem Elbasan, me Vendim Nr.739/13-2024-2032, ka vendosur uljen e denimit per te denuarin Dritan Dajti ne masen 43 dite. Ne faqen 2, Kapitulli II te ketij vendimi thuhet:

Së pari, me vendimin Nr.1108, datë 11.05.2020 Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan ka vendosur bashkimin e dënimeve të dhëna për të dënuarin Dritan Dajti, në një denim të vetëm me 25 (njëzet e pesë) vite burgim; konkretisht bashkimin e denimit me 25 vjet burgim dhene me vendimin Nr.13, datë 08.02.2019 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, me denimin 23 vjet burgim dhene me Vendimin Nr.146 Akti date 17.03.2006, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane. Ky vendim ka marrë formë të prerë pa u ankimuar nga palët, me datë 26.05.2020.

Së dyti, nga përmbajtja e shkresës "Dinamika e vuajtjes së dënimit për të dënuarin" rezulton se nga data e arrestimit, datë 07.08.2009, deri më datë 30.04.2024 i dënuari ka vuajtur gjithësej 24 (njëzet e katër) vjet, 8 (tete) muaj e 13 (trembëdhjetë) ditë (lidhja 2).

Me 11 Qershor 2024, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur: *Prishjen e vendimit nr.13 datë 08.02.2019 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe lënien në fuqi të vendimit nr.95, datë 23.07.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.*

Me 04 Korrik 2024, me Shkresën Nr.756/5 Prot., Prokuroria e Pergjithshme i ka derguar Prokurorise pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, Vendimin e arsyetuar të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë Nr.00-2024-1069 (140), që kish vendosur në datë 11.06.2024, *Prishjen e vendimit nr.13 datë 08.02.2019 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe lënien në fuqi të vendimit nr.95, datë 23.07.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda (lidhja 3).*

Vlen të theksohet fakti që në fund të kësaj shkrese, lidhur me ekzekutimin e Vendimit Nr.95, datë 23.07.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, shprehimisht thuhet: Sqarojme se, ky vendim ju dergohet, bazuar në percaktimet e bera në vendim e mesiperm (paragrafi 84 i vendimit të arsyetuar).

Duke ju referuar paragrafi 84 të Vendimit në fjale të Gjykatës së Lartë, konstatojmë që lidhur me ekzekutimin e Vendimit Nr.95, datë 23.07.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Kolegji Penal deklaron shprehimisht se:

Me ekzekutimin e vendimeve në baze të ligjit nr. 79/2020 "Per ekzekutimin e vendimeve penale", do të jenë prokurorite pranë gjykatave të juridiksionit të pergjithshem sipas kompetences tokesore, neni 76 i KPP, te vendit ku ka ndodhur vepra penale ne kete rast ose vendit ku ekzekutohet vendimi.

Me 04 Korrik 2024, i dënuari Dritan Dajti dhe avokati i zgjedhur prej tij z.Alban Kapxhiu, i kanë kërkuar Drejtorit të I.E.V.P. Peqin, lëshimin e urdherit për **kryerjen e procedurës së lirimit**, për shkak se në orën 24.00 të datës 04.07.2024, atij i perfundonte ekzekutimi i vendimit të dënimit me 25 vjet burgim. Kjo në respekt të zbatimit të Nenit 30 të LIGJIT Nr.79/2020 PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE PENALE dhe Nenit 79 të LIGJIT Nr.81/2020 PËR TË DREJTAT DHE TRAJTIMIN E TË DËNUARVE ME BURGIM, ku respektivisht thuhet:

*Dënimi me burgim vlerësohet i plotësuar dhe i dënuari lirohet kur përfundon kryerjen e dënimit.
... Procedura e liritimit kryhet nga institucioni i ekzekutimit të vendimit penal.*

*Lirimi i të dënuarit bëhet kur përfundon ekzekutimi i vendimit të dënimit ose, në bazë të ligjit, me vendim të organit kompetent. Personeli i institucionit kryen veprimet bazuar në **urdhrit me shkrim të drejtorit të institucionit**;*

Sa sipër, Kërkesa për lëshimin e urdherit për kryerjen e procedurës së liritimit të të dënuarit **Dritan Dajti** lidhet drejtpërdrejtë me detyrimin ligjor që kishte I.E.V.P. Peqin, për të zbatuar Vendimin Nr.739/13-2024-2032, datë 30.04.2024, të Gjykatës së Shkallës së Përë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, e cila kishte vendosur uljen e dënimit për Dritan Dajtin në masën 43 ditë. Vendim ky që kishte marrë formë të prirë po në datën 04.07.2024; data kur Dritan Dajti përfundonte kryerjen e dënimit me 25 vjet burgim sipas përlogaritjeve dhe vlerësimit të gjykatës në këtë vendim.

Por siç rezultoi në fakt, ndonjë Dritan Dajti e kishte përfunduar ekzekutimin e vendimit të dënimit me 25 vjet burgim, I.E.V.P. Peqin nuk disponoi për lirim të tij, me pretendimin që Gjykata e Shkallës së Përë Elbasan ende nuk ja kishte dërguar I.E.V.P. Peqin Vendimin Nr.739/13-2024-2032, datë 30.04.2024, për uljen e dënimit të Dritan Dajtit në masën 43 ditë.

Me 05 Korrik 2024, i dënuari **Dritan Dajti** dhe avokatet e tij z.**Alban Kapxhiu** dhe z.**Alban Qafa**, kanë paraqitur në Gjykatën e Shkallës së Përë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, kërkesën për konstatimin dhe deklarin e përfundimit të ekzekutimit të vendimit të dënimit me 25 vjet burgim, të të dënuarit **Dritan Hasan Dajti**.

Shortimi i kësaj kërkesë në Gjykatën e Shkallës së Përë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, caktoi si gjyqtare të çështjes znj.**Suela Lika**.

Me 08 Korrik 2024, I.E.V.P. Peqin, nisur nga fakti që kerkuesi po e përfundonte kryerjen e dënimit edhe pa përlogaritur uljen e dënimit me 43 ditë të dhënë nga Gjykata e Shkallës së Përë Elbasan; dhe meqenëse përveç urdherit të ekzekutimit të vendimit penal që ai po vuante nuk dispononte asnjë urdher ekzekutimi tjetër për ndonjë vendim penal ndaj tij; me inicjativën e vet dhe pa asnjë bazë ligjore, me Shkresën Nr.2928 Prot., i ka kërkuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Përë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Vendimin Penal **Nr.95** datë 23.07.2014.

Kjo me synimin dhe shpresen qe se bashku me Vendimin Penal **Nr.95** date 23.07.2014, Gjykata e Posaçme te Shkalles se Pare per Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, **t'i dergonte I.E.V.P.Peqin edhe Urdherin e Ekzekutimit te ketij Vendimi, si mundesi e vetme per ta mbajtur kerkuesin te burgosur.**

Kjo Shkrese eshte me vlere per kerkuesin sepse ka zbuluar faktin qe I.E.V.P. Peqin deri ne daten 08.07.2024, nuk e dispononte as **Vendimin Penal Nr.95** date 23.07.2014 dhe as Urdherin e Ekzekutimit te ketij Vendimi.

Me 11 Korrik 2024, me Shkresen Nr.2672/1 Prot., Gjykata e Posaçme e Shkalles se Pare per Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar i ka derguar I.E.V.P.Peqin, **fotokopjen e njehsuar me origjinalin te Vendimin Penal Nr.95** date 23.07.2014, ku shprehimisht thote:

*Ne pergjigje te shkreses suaj nr.2928 prot, datë 08.07.2024, ku nga ana juaj kerkohet vendimi penal ne lidhje me shtetasin **Dritan Dajti**, i biri i Hasanit dhe i Aferdites lindur me 17.11.1971, ne Tirane, bashkelidhur ju dergojme **fotokopjen e njehsuar me origjinalin te vendimit penal me nr.95, date 23.07.2014**, te Gjykatës se Posaçme te Shkalles se Pare për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, se bashku me shenimet perkatëse çfare kanë vendosur gjykatat me te larta (lidhja 4).*

Sa siper, kjo Shkrese hedh drite mbi disa fakte:

Se pari, Gjykata e Posaçme e Shkalles se Pare per Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar i ka derguar I.E.V.P.Peqin, fotokopjen e njehsuar me origjinalin te Vendimit Penal me Nr.95, date 23.07.2014 dhe **jo origjinalin e ketij Vendimi.**

Se dyti, Gjykata e Posaçme e Shkalles se Pare per Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar **nuk i ka derguar I.E.V.P.Peqin, Urdherin e Ekzekutimit te Vendimit Penal Nr.95, date 23.07.2014.**

Se treti, ne faqjen e fundit te fotokopjes se njehsuar me origjinalin te Vendimit Penal **Nr.95**, date 23.07.2014, i cili i eshte derguar I.E.V.P.Peqin nga Gjykata e Posaçme e Shkalles se Pare për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, shprehimisht thuhet:

*SHËNIM: Kunder vendimit nr. 13, date 08.02.2019, te Gjykatës Apelit per Krime te Rënda, ka bërë rekurs Prokuroria pranë Gjykatës Apelit per Krimet e Renda, si dhe kunder-rekurs i pandehuri **Dritan Dajti**.*

*Gjykata e Lartë, Tiranë me vendimin nr: **00-2024-1069, (140)**, date 11.06.2024, ka vendosur:*

- Prishjen e vendimit **nr. 13**, date 08.02.2019, te Gjykatës së Apelit për Krime të Renda dhe lenien ne fuqi të vendimit **nr. 95**, date 23.07.2014, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Renda.

Pra, aktualisht ndodhemi perballe nje paradoksi klasik ku Gjykata e Larte me daten 11.06.2024, deklaroi se Vendimi Penal Nr.95, date 23.07.2014, eshte dhene nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Renda; nderkohe qe Gjykata e Posaçme e Shkalles se Pare per Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ne daten 08.07.2024, pretendon te kunderten; qe ky Vendim eshte dhene prej saj.

Me 28 Korrik 2024, me Shkresen Nr.3223 Prot., I.E.V.P. Peqin, i ka derguar znj.Suela Lika gjyqtare prane Gjykates se Shkalles se Pare Elbasan e cila po gjykon kerkesen e Dritan Dajtit per konstatimin dhe deklarimin e perfundimit te ekzekutimit te vendimit të dënimit te tij me 25 vjet burgim:

- 1. Vendimin Penal Nr.95** date 23.07.2014, te Gjykates se Posaçme te Shkalles se Pare per Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ne ngarkim te shtetasit **Dritan Dajti** te treguar me larte.
- 2. Dinamiken e Vuajtjes se Denimit** te te denuarit **Dritan Dajti** te llogaritur deri daten 11.06.2024, ku shprehimisht thuhet:

Me Vendimin nr. 1108, date 11.05.2020 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur: Bashkimin e dënimeve për të dënuarin Dritan Dajti të dhëna ndaj tij me Vendimin penal Nr. 146 date 17.03.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane me te cilin është dënuar me 23 vjet burgim, dhe të Vendimit penal Nr. 13 date 08.02.20197 të Gjykatës së Apelit për Krime të Renda Tiranë me të cilin eshte dënuar 25 vjet burgim, në një dënim të vetëm, duke e dënuar Dritan Dajtin përfundimisht me 25(njzet e pesë) vite burgim.

Vendimi ka marre formë të prere me datë 26.05.2020.

Nga dënimi dhënë ka vuajtur 24 vjet 09 muaj 24 ditë.

Nga dënimi i dhënë mbeten për të vuajtur 2 muaj 06 ditë.

Perllogaritjet jane bere me date 11.06.2024 (lidhja 5).

Pra sipas dinamikës së mesiperme të vuajtjes së dënimit të perllogaritur me datë 11.06.2024, paraqitur zyrtarisht Gjykates se Shkalles se Pare Elbasan nga I.E.V.P. Peqin, rezultoi se:

Kerkuesi Dritan Dajti, ndonse prej dates 17.08.2024, ka perfunduar ekzekutimin e vendimit të dënimit te tij me 25 vjet burgim sipas Vendimit Nr.1108, date 11.05.2020, te Gjykates se Rrethit Gjyqësor Elbasan; ndodhet prej dy ditesh ne kushtet e heqjes se lirise me burgim ne rruge jashtegjyqesore, nga autoritetet e I.E.V.P.Peqin.

Kapitulli II. Parshtime lidhur me faktin qe shtetasit Dritan Dajti i eshte hequr liria me burgim ne rruge jashte gjyqesore.

Shtetasi Dritan Dajti nderkohe qe ka përfunduar kryerjen e dënimit me 25 vjet burgim sipas vendimit te Gjykates, urdherit te ekzekutimit te Prokurorit dhe Dinamikes se Vuajtjes se Denimit te leshuar nga Drejtori i I.E.V.P. Peqin; prej dy ditesh vazhdon te mbahet i burgosur nga autoritetet e I.E.V.P.Peqin, ne shkelje flagrante te neneve 4/1 dhe 27/1 te Kushtetutes ku respektivisht sanksionohet:

E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit.

Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj.

Sa siper, procedurat ligjore per kete rast parashikojne qarte se qe prej dates 17.08.2024, Drejtori i I.E.V.P. Peqin duhej te leshonte urdherin per **kryerjen e procedures se lirimit**, pasi ne oren 24.00 te dates 17.08.2024, Kerkuesit Dritan Dajti i perfundonte ekzekutimi i vendimit të dënimit me 25 vjet burgim. Kjo ne respekt e zbatim te Nenit 30 te LIGJIT Nr.79/2020 PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE PENALE dhe Nenit 79 te LIGJIT Nr.81/2020 PËR TË DREJTAT DHE TRAJTIMIN E TË DËNUARVE ME BURGIM, ku respektivisht thuhet:

Dënimi me burgim vlerësohet i plotësuar dhe i dënuari lirohet kur përfundon kryerjen e dënimit. ... Procedura e lirimit kryhet nga institucioni i ekzekutimit të vendimit penal.

Lirimi i të dënuarit bëhet kur përfundon ekzekutimi i vendimit të dënimit ose, në bazë të ligjit, me vendim të organit kompetent. Personeli i institucionit kryen veprimet bazuar në urdhrin me shkrim të drejtorit të institucionit.

Kapitulli III. Parashtime lidhur me faktin qe I.E.V.P. Peqin nuk disponon asnje Urdher Ekzekutimi qe e mban te burgosur shtetasin Dritan Dajti, ne respekt e zbatim te Ligjit Nr.79/2020 PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE PENALE.

Ne Nenin 12 te Ligjit Nr.79/2020 PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE PENALE, shprehimisht thuhet:

1. *Urdhri i ekzekutimit është akti procedural që nxjerr prokurori për vënien në ekzekutim të vendimit gjyqësor penal. Urdhri i ekzekutimit përmban:*
 - a. *gjykatën që ka dhënë dhe/ose ka ndryshuar vendimin penal numrin, datën, përmbajtjen e plotë të dispozitivit të vendimit penal objekt ekzekutimi dhe disponimet e nevojshme për ekzekutimin;*
 - b. *gjeneralitetet e personit ndaj të cilit do të ekzekutohet vendimi penal, adresën e vendbanimit ose të vendqëndrimit, pranë së cilës do të kryhet njoftimi i urdhrin të ekzekutimit;*
 - c. *llojin dhe masën e dënimit kryesor, si dhe kohëzgjatjen tërësore të kryerjes së dënimit, sipas procedurave të parashikuara në Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale dhe rregullave të parashikuara në këtë ligj;*
 - c) *llojin e dënimit plotësues dhe kriteret e zbatimit të tij;*
 - d. *në rastet e dënimit me burgim, llojin e sigurisë që duhet të ketë vendi i kryerjes së dënimit, sipas përcaktimit të bërë nga gjykata në dispozitivin e vendimit penal kryesisht ose bazuar në kërkesën e prokurorit për përcaktimin e llojit të sigurisë, sipas nenit 24 të këtij ligji;*
 - dh. *detyrimin civil në procesin penal;*
 - e. *organet që ekzekutojnë vendimin;*
 - ë) *detyrimin e organeve që ekzekutojnë vendimin penal për njoftimin e fillimit të ekzekutimit.*
2. *Prokurori pranë gjykatës së apelit ose Gjykatës së Lartë, menjëherë pas administrimit të vendimit përmbledhës, ia dërgon zyrtarisht prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë, e cila ka përgjegjësinë e ekzekutimit të vendimit.*
3. *Urdhri i ekzekutimit nxirret nga prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin e dënimit.*

Sa siper, deri ne daten 19.08.2024, dite kur eshte depozituar kjo kerkese ne Gjykatën e Shkalles se Pare Elbasan, I.E.V.P.Peqin nuk disponon absolutisht asnje Urdher Ekzekutimi nga cilado prokurori prane gjykatave te shkalles se pare ne Republiken e

Shqiperise, qe te vere në ekzekutim ndonje vendim gjyqësor penal, qe e mban te burgosur shtetasin **Dritan Dajti**.

Kapitulli VI. Parashtrime lidhur me faktin qe I.E.V.P. Peqin nuk disponon asnje Urdher Ekzekutimi, qe e mban te burgosur shtetasin Dritan Dajti, ne respekt e zbatim te K.Pr.Penale.

Ne Nenin 463 te K.Pr.Penale, me titull "Veprimet e prokurorit, shprehimisht thuhet:

1. Prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin, merr masa për ekzekutimin e vendimit. Ai bën kërkesa në gjykatën kompetente dhe ndërhyr në të gjitha veprimet e ekzekutimit.

2. Vendimet e prokurorit i njoftohen, brenda tridhjetë ditëve, mbrojtësit të caktuar nga i interesuari ose, kur nuk ka të tillë, atij të caktuar nga prokurori.

3. Kur është e nevojshme, prokurori mund të kërkojë kryerjen e veprimeve të veçanta nga prokurori i një rrethi tjetër.

4. Kur fillon ekzekutimi, prokurori njofton me shkrim gjykatën që ka dhënë vendimin.

Sa siper, deri ne daten 19.08.2024, dite kur eshte depozituar kjo kerkese ne Gjykatën e Shkalles se Pare Elbasan, I.E.V.P.Peqin nuk disponon absolutisht asnje Urdher Ekzekutimi nga cilado prokurori prane gjykatave te shkalles se pare ne Republiken e Shqiperise, qe te vere në ekzekutim ndonje vendim gjyqësor penal, qe e mban te burgosur shtetasin **Dritan Dajti**.

Kapitulli V. Parashtrime lidhur me faktin qe Vendimi i arsyetuar i Kolegjit Penal te Gjykares se Larte Nr.00-2024-1069 (140), date 11.06.2024, parashikon qarte proceduren e ekzekutimit te Vendimit Nr.95, date 23.07.2014.

Me Shkresen Nr.756/5 Prot., Prokuroria e Pergjithshme i ka derguar Prokurorise prane Gjykares se Rrethit Gjyqesor Elbasan, Vendimin e arsyetuar te Kolegjit Penal te Gjykares se Larte Nr.00-2024-1069 (140), qe kish vendosur ne date 11.06.2024, Prishjen e vendimit nr.13 datë 08.02.2019 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe lënien në fuqi të vendimit nr.95, datë 23.07.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Vlen te theksohet fakti qe ne fund te kesaj shkrese, lidhur me ekzekutimin e Vendimit Nr.95, datë 23.07.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, shprehimisht thuhet: *Sqarojme se, ky vendim ju dergohet, bazuar ne percaktimet e bera ne vendim e mesiperm (paragrafi 84 i vendimit te arsyetuar).*

Duke ju referuar paragrafi 84 te Vendimit ne fjale te Gjykates se Larte, konstatojme qe lidhur me ekzekutimin e Vendimit Nr.95, datë 23.07.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Kolegji Penal deklaroi shprehimisht se:

Me ekzekutimin e vendimeve në baze te ligjit nr. 79/2020 "Per ekzekutimin e vendimeve penale", do te jenë prokurorite prane gjykatave te juridiksionit te pergjithshem sipas kompetences tokesore, neni 76 i KPP, te vendit ku ka ndodhur vepra penale ne kete rast ose vendit ku ekzekutohet vendimi.

Kapitulli VI. Parashtrime lidhur me marrjen e vendimit brenda 48 oreve per ligjshmerine e kesaj mase te marre nga I.E.V.P. Peqin, ndaj shtetasit **Dritan Dajti.**

Ne Nenin 28/4 te Kushtetutes sanksionohet:

Në të gjitha rastet e tjera, personi, të cilit i hiqet liria në rrugë jashtëgjyqësore, mund t'i drejtohet në çdo kohë gjyqtarit, i cili vendos brenda 48 orëve për ligjshmërinë e kësaj mase.

Siç rezulton ne fakt, Kerkuesit Dritan Dajti ka dy dite qe i eshte hequr liria ne rruge jashtegjyqesore nga I.E.V.P.Peqin, pa e njoftuar per aresyet e kesaj mase te marre nga ky institucion.

Ne keto kushte, duke u perballur me keto shkelje flagrante te ligjit dhe te se drejtes, dispozitat e Kushtetutes qe garantojne lirine dhe sigurine juridike zbatohen drejtepersedrejti, ne respekt te Nenit 4 te Kushtetutes ku sanksionohet:

- 1. E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit.*
- 2. Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë.*
- 3. Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe.*

Kapitulli VII. Konkluzione.

Nisur nga argumentet, objeksionet dhe observimet e parashtruara, si dhe ne respekt e zbatim te Nenit 28/4 te Kushtetutes dhe Nenit 480 te K.Pr.Penale, ku respektivisht thuhet:

Në të gjitha rastet e tjera, personi, të cilit i hiqet liria në rrugë jashtëgjyqësore, mund t'i drejtohet në çdo kohë gjyqtarit, i cili vendos brenda 48 orëve për ligjshmërinë e kësaj mase;

Në fazën e ekzekutimit, gjykata është kompetente të vendosë për shuarjen e veprës penale pas dënimit, për shuarjen e dënimit, për dënimet plotësuese, për konfiskimin ose kthimin e sendeve të sekuestruara, si dhe për çdo rast të parashikuar me ligj;

Kur vërtetohet shuarja e veprës penale ose të dënimit, gjykata e deklaron këtë edhe kryesisht, duke marrë masat përkatëse;

K e r k o j m e :

1. Pranimin e kerkeses.
2. Konstatimi i heqjes se lirise me burgim ne rruge jashtegjyqesore dhe marrja e vendimit brenda 48 oreve per ligjshmerine e kesaj mase te marre nga I.E.V.P. Peqin ndaj shtetasit **Dritan Dajti**.
3. Deklarimin kryesisht te shuarjes se denimit me 25 vjet burgim, te shtetasit Dritan Dajti.
4. Lirimin e menjehershem te shtetasit Dritan Dajti.

Peqin me 19 Gusht 2024.

Me Konsiderate

Dritan DAJTI

Av.Alban QAFA

Av.Alban KAPXHIU